



UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 10 /2006, datë 9/10/2006

NË ZBATIM
TË RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2005/56 DHE RREGULLORES NR.
2006/1(TË NDRYSHUAR) mbi TAKSËN SHITESË NË FITIMET NETO

Ministri i Ekonomisë dhe Financave,

Duke patur parasysht nenin 60 të Ligjit Nr. 2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”, si dhe

Në përputhje me nenin 2, paragrafin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/56 mbi Taksën Shtesë në Fitimet Neto të Përgjithshme të Ndërmarrjeve që merren me veprimtari afariste nga pozita dominuese në treg brenda Kosovës dhe me qëllim të qartësimit të mëtejshëm të çështjeve përkatëse që lidhen me pagesën, nxjerr këtë Udhëzim Administrativ në zbatim të kësaj Rregulloreje.

Neni 1

Përkufizimet

“Rregullore” nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/56 dhe Nr. 2006/1 mbi Taksën Shtesë në Fitimet Neto të Përgjithshme të Ndërmarrjeve që merren me veprimtari afariste nga pozita dominuese në treg brenda Kosovës

“Veprimtari ekonomike” ka kuptimin që është dhënë në nenin 1 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat.

“Pozitë dominuese e privilegjuar” nënkupton ofruesin e vetëm të mallrave apo të shërbimeve të caktuara bazuar në ndonjë autorizim të lëshuar nga organi kompetent apo ky status i njihet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi .

“Të ardhurat bruto” do të thotë të gjitha të ardhurat e fituara ose të akumuluar, duke përfshirë mes tjerash, të ardhurat nga veprimtaritë e prodhimit, tregtisë, financave, investimeve, veprimtarisë profesionale ose veprimtarive të tjera ekonomike;

Neni 2

Subjektet që ngarkohen me taksën shtesë

- 2.1 Sipas nenit 1, paragrafit 1.1 të Rregullores çdo korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë; çdo ndërmarrje afariste që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike; çdo organizatë e regjistruar në UNMIK si organizatë joqeveritare në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 mbi regjistrimin dhe punën e oganizatave joqeveritare në Kosovë si dhe çdo ndërmarrje e përhershme e një personi jorezident me të ardhura bruto më të larta se njëqind milion euro dhe të cilët zhvillojnë aktivitet afarist duke shfrytëzuar pozitën dominuese të privilegjuar në tregun brenda Kosovës dhe në këtë mënyrë pjesa më e madhe e profitit realizohet nga kjo pozitë janë të obliguar që në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës të paguajnë një taksë shtesë në shkallën prej 30 % të fitimit vjetor neto do me thënë pasi që subjekti përkatës është tatuar në bazë të legjislacionit tatimor.
- 2.2 Sipas nenit 2.1 shihet se për t'u aplikuar taksa shtesë tek subjektet, duhet të plotësohen dy kritere:
- që subjekti të realizojë të ardhura bruto vjetore mbi njëqind milion euro dhe
 - që të gëzojë pozitën dominuese në tregun përkatës brenda Kosovës.
- Cila do nga këto dy kritere nëse mungon, subjekti përkatës nuk do të ngarkohet me taksën shtesë.
- 2.3. Fitimi vjetor neto është shuma që mbetet pas pagesës së taksave si dhe pagesës së tatimit nga të ardhurat e ndërmarrjes . Pra, taksa shtesë është ajo pagesë që kryhet nga tatimpaguesi i cili i përmbush kriteret në bazë të paragrafit 2.1 dhe 2.2 të këtij Udhëzimi Administrativ, përveç pagesës së tatimit në të ardhurat e realizuara nga korporata.
Pra, bazë për përcaktimin e shumës së taksës shtesë merret shuma e fitimit të mbetur pas pagesës së tatimit në të ardhurat nga korporata/tatimi në fitim.
- 2.4 Tatimpaguesi mund të lirohet nga ngarkesa me taksë shtesë në fund të atij tremujori kalendarik brenda të cilës periudhë e ka humbur pozitën dominuese të privilegjuar në tregun e Kosovës.
- 2.5 Në rast se tatimpaguesi e humb pozitën dominuese p.sh. në muajin gusht të vitit 2006 d.m.th në tremujorin e tretë kalendarik atëherë për përcaktimin e shumës së taksës shtesë merret në konsiderim fitimi neto vjetor pas pagesës së tatimit në të ardhura nga korporatat/tatimi në fitim, dhe nga shuma e cila i obligohet për pagesë të taksës shtesë zbritet $\frac{1}{4}$ e fitimit të përgjithshëm neto vjetor.
Shuma e tillë për pagesë do të ndahet në katër këste të barabarta dhe do të paguhet në çdo tremujor të vitit kalendarik vijues.
- 2.6 Mënyra e pagesës së taksës shtesë është e përcaktuar me nenin 1.5 të Rregullores në fjalë, sipas të cilës ajo pagesë bëhet në katër (4) këste të barabarta në fund të çdo tremujori kalendarik (më së voni deri me 31 mars, 30 qershor, 30 shtator, 31 dhjetor) për vitin kalendarik i cili pason pas periudhës tatimore në të cilën aplikohet taksa shtesë.

Neni 3

Zbatimi

- 3.1 Çdo tatimpagues i cili është i obliguar që të paguajë taksën shtesë sipas nenit 2.1 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe nuk e bën një gjë të tillë do t'i nënshtrohet dipozitave ligjore mbi gjobat dhe ndëshkimet sikur çdo lloj tjetër i tatimeve bazuar në Ligjin Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.
- 3.2 Përgaditja e formave tatimore dhe çdo çështje që lidhet me zbatimin më të lehtë të kësaj takse mbetet në përgjegjësi të autoriteteve të Administratës tatimore të Kosovës.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe është i aplikueshëm për periudhën prej 01.01.2005 prej kur ka filluar të vlejë Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut Nr. 2006/1 mbi taksën Shtesë në Fitimet Neto.

Me datë

09/10/06 / Z. Hatri

Ministri i Ekonomisë dhe Financave
Z. Haki Shatri Z. Hatri